



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1113/9 prot.

Datë 06.06.2024

### V E N D I M

Nr. 632/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.06.2024 shqyrtoi ankesën me:

#### Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “SAHORA” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr. REF-97126-03-04-2024, me objekt: “*Blerje elektropompa zhytëse e panele*”, me fond limit 18,000,000 (*tetëmbëdhjetë milion*) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “VASAA” SHPK në procedurën e prokurimit.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “SAHORA” SHPK me NIPT L91703022T dhe adresë Rruga “Komuna e Parisit”, Hyrja 2, Apartamenti 30, ap me nr. Pasurie 6/758+2-30, vol nr.59, fq 31, Tiranë.

**Subjekt i interesuar:** Operatori ekonomik “VASAA” SHPK me NIPT J62903470T dhe adresë Fier Fier Fier, FIER, L. “Kryengritja e Fierit”.

**Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Fier Sh.A. me adresë Lagjia:“1 Maji”, Rruga:“Tasi Dema” Fier

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

### **Vëren:**

#### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 05.03.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-97126-03-04-2024, me objekt: “Blerje elektropompa zhytëse e panele”, me fond limit 18,000,000 (tetëmbëdhjetë milion) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A.

II.2. Në datën 02.04.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezulton, se në datën 08.04.2024, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

- “VASAA” SHPK,	13.940.000 lekë	kualifikuar
- “ASI-2A CO” SHPK,	15.000.000 lekë	skualifikuar
-“SAHORA” SHPK,	16.690.000 lekë	skualifikuar
- “INPLY” SHPK	17.800.000 lekë	skualifikuar
- “MIKAEL-GRUP” SHPK,	pa oferte ekonomike.	skualifikuar
- P.F Vasil Belishta nuk ka paraqitur ofertë ekonomike		skualifikuar

II.3.1. Operatori ekonomik “SAHORA” SHPK rezulton i skualifikuar për arsye se: “•Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.1.1 të Kapacitetit profesional, pasi referuar ekstraktit të QKB, nuk ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim”.

II.4. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton, se më 02.05.2024 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.5. Në datën 07.05.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik me numër ankimimi A/2024/4045, datë 07.05.2024 dhe me Nr.1113/2024 Prot., datë 07.05.2024, e operatorit ekonomik "SAHORA" SHPK për procedurën e prokurimit, "Procedurë e hapur" me Nr. REF-97126-03-04-2024, me objekt: "Blerje elektropompa zhytëse e panele", me fond limit 18,000,000 (tetëmbëdhjetë milion) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A, ku u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "SAHORA" SHPK, si dhe mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "VASAA" SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1113/2 prot., datë 08.05.2024.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr.928/2 prot., datë 10.05.2024, protokolluar me tonën nr. 1113/34 prot., datë 13.05.2024, autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacionin dhe vendimin lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, nga ku rezulton, se KSHA e autoritetit kontraktor me vendimin nr.928/1 prot., datë 10.05.2024, ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke argumentuar "[...]  
*Nga shqyrtimi i materialeve, Komisioni si më poshtë relaton:*

*Në datën 02.04.2024, është hapur procedura e prokurimit me nr.REF-97126-03-04-2024 dhe janë konstatuar 6 (gjashtë) operatorë ekonomik pjesëmarrës në procedurë.*

*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka mbyllur procesin e vlerësimit dhe klasifikimit të ofertave në datë 08.04.2024.*

*1. Operatori ekonomik "ASI-2A CO" SHPK NIPT KS3002402C me vlerë oferte 15.000.000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë pa TVSH - skualifikuar*

*2. Operatori ekonomik "INPLY" SHPK 7 NIPT L51503032Q me vlerë oferte 17.800.000 (shtatëmbëdhjetë milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH - skualifikuar*

*3. Operatori ekonomik "MIKAEL-GRUP" SHPK NIPT KW4108001G nuk ka paraqitur ofertë - skualifikuar*

4. Operatori ekonomik "SAHORA" SHPK 1 NIPT L91703022T me vlerë oferte 16.690.000 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH - skualifikuar

5. Operatori ekonomik "VASAA" SHPK INIPT 162903470T me vlerë oferte 13.940.000 (trembëdhjetë milion e nëntëqind e dyzetë mijë) lekë pa TVSH —i kualifikuar

6. Operatori ekonomik person fizik Vasil Belishta NIPT L74605006C nuk ka paraqitur ofertë dhe është skualifikuar.

KVO pas vlerësimit, i ka dërguar OE të kualifikuar i pari "VASAA" SHPK, kërkesën për të dorëzuar dokumentacionin fizik brenda datës 15.04.2024.

Po anë datë 15.04.2024 në portalin E-Albania është depozituar ankesa e parë nga operatori ekonomik "SAHORA" shpk. Autoriteti Kontraktor me shkresat nr.800 prot date 18.04.2024 dhe 800/1 prot date 22.04.2024, ka njoftuar KPP-në mbi Vendimin e Komisionit të shqyrtimit të ankesës, i cili konkludoi në mos-pranimin e ankesës, për shkak se ankimesit nuk i kishte lindur e drejta e ankesës sipas dispozitave ligjore. KPP me Vendimin nr.383/2024 prot datë 23.04.2024, vendosi Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik "SAHORA" SHPK, pasi ankesa e dorëzuar nga OE ankimes, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranim. Gjithashtu KPP ndër të tjera referon edhe pikën 7 të nenit 110 "Afatet për ankimim" të Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", ku citohet: Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, referuar nenit 110 pika 7 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Operatori Ekonomik "SAHORA" shpk, nuk mund ta ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë AK dhe KPP.

Në këto kushte, pretendimet dhe ankesa e operatorit ekonomik "SAHORA" shpk, nuk merret në konsideratë."

II.8. Nga shqyrtimi i materialeve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në formë shkresore dhe as në sistem elektronik.

II.9. Me shkresën nr. 1113/4 prot., datë 28.05.2024, me lëndë "Kërkesë për informacion", KPP iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Standartizimit me kërkesën si më poshtë: " Në kuptim e zbatim të nenit 24 pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.

*Në kuadër të shqyrtimit të një ankese që ka si objekt “Blerje elektropompa zhytëse e panele”, lind e nevojshme të na i nformoni për sa më më poshtë:*

- 1. A ekziston certifikata e cilësisë ISO 9906:2012 e klasës 3B; më të lartë ose ekuivalente me të?*
- 2. Nëse po, cila është lidhje mes certifikatës ISO 9906:2012 dhe standarteve: SSH EN 809; SSH EN ISO 12100; SSH EN 60034, SSH EN ISO14121; SSH EN ISO 3744?*

*Për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik si dhe për një shqyrtim më të plotë e objektiv të ankesës, lutemi brenda dy ditëve nga marrja e kësaj shkrese dërgimin e informacionit më sipër.”*

II.10. Me shkresën nr. 213/1 prot., datë 03.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 03.06.2024, në përgjigje të kërkesës më sipër Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit ka njoftuar KPP si më poshtë vijon:

*“Lidhur me sa kërkoni në shkresën Tuaj me nr.1113/4 prot, datë 28.05.2024 “Kërkesë për informacion”, ju informojmë se Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, bazuar në Ligjin nr.9870/2008 “Për Standardizimin”, të ndryshuar, nuk disponon informacion mbi ekzistencën e certifikatave të cilësisë që lëshohen nga organizma të certifikimit mbi shkallën e zbatimit të një standardi të caktuar, në rastin konkret të standardit ISO 9906:2012, klasa 3B.*

*Sa i përket pyetjes në pikën 2 të shkresës tuaj, ju informojmë lidhur me statusin e standardeve dhe çfare kanë të përbashkët (nëse e kanë) me standardin ISO 9906:2012, sa vijon:*

***Standardi ndërkombëtar (ISO 9906:2012) “Pompa rotodinamike — Testet e pranimi të performancës Hidraulike - Klasat 1, 2 dhe 3” specifikon testet e performancës hidraulike për pranimin nga klientët të pompave rotodinamike (pompa centrifugale, me prurje të përzier dhe pompa aksialefboshtore). Ai synon të përdoret për pranimin e pompës që testohen në objektet e testimi të pompave, të tilla si objektet e testimi të pompës të prodhuesit ose të laboratorëve. Standardi ISO 9906:2012 mund të zbatohet për pompat e çdo madhësie dhe për çdo lëng/likuid të pompuar që sillet si ujë i pastër dhe i ftohtë. Ai specifikon tre nivele pranimi:***

- nivelet 1B, 1E dhe 1U me tolerancë më të fortë:*
- nivelet 2B dhe 2U me tolerancë më të gjerë: “*
- nivelin 3B me tolerancë edhe më të gjerë.*

*Standardi zbatohet ose për vetë pompën pa asnjë pajisje tjetër ose për një kombinim të një pompe të lidhur me të gjitha ose me një pjesë të pajisjeve të saj në rrjedhën e sipërme dhe/ose në rrjedhën e poshtme.*

**Standardi Evropian EN 809:2009** “Pompat dhe njësitë e pompave për lëngje - Kërkesat e përbashkëta të Sigurisë” është standard i harmonizuar nën Direktivën Evropiane 2006/442 “Për Makineritë” dhe përcakton kërkesat e sigurisë teknike për:

- ndërtimin;
- montimin;
- ngritjen;
- operimin; dhe
- përdorimin

e një pompe ose një njësie pompe për likuide. Standardi përmban një listë të rrisqeve të rëndësishme, të cilat mund të lindin me përdorimin e një pompe ose një pjese të pompës së ujit lëngut dhe gjithashtu përcakton kërkesat dhe/ose masat mbrojtëse që do të çojnë në uljen e këtyre rrisqeve.

Pompat (për ujë) lëng që mbulohen nga ky standard janë:

- pompat rotodinamike: - pompat rrotulluese me zhvendosje pozitive;
- pompat me zhvendosje reciproke;

të cilat furnizohen veçmas pa ngasje (motor elektrik ose me motor me djegie të brendshme).

**Standardi SSH EN ISO 12100** “Siguria e makinerive - Parimet e përgjithshme për projektim - Vlerësimi i rrezikut dhe reduktimi i tij” është standard i harmonizuar nën Direktivën Evropiane 2006/42 “Për Makineritë”. Ky standard Evropian ka adoptuar **Standardin ndërkombëtar ISO 12100** “Siguria e makinerive - Parimet e përgjithshme për projektimin - Vlerësimi i rrisikut dhe reduktimi i tij”, i cili **specifikon terminologjinë, parimet bazë dhe një metodologji** për arritjen e sigurisë në projektimin e makinerive, si dhe specifikon parimet e vlerësimit të rrisikut dhe reduktimin e tij për të ndihmuar projektuesit në arritjen e këtij objekti. Procedurat përshkruhen për identifikimin e rrisqeve dhe përlllogaritjet dhe vlerësimin e rrisqeve gjatë fazave përkatëse të ciklit jetësor të makinës, dhe për eliminimin e rrisqeve ose sigurimin e reduktimit të mjaftueshëm të rrisikut.

Ky standard ndërkombëtar synon gjithashtu të përdoret si bazë për përgatitjen e standardeve të sigurisë tip-B (që janë standarde të përgjithshme dhe që trajtojnë aspekte të sigurisë për një gamë të gjerë makinerish) ose tip-C (që janë standarde për sigurinë e makinerive dhe që trajtojnë në detaje kërkesat e sigurisë për një lloj makine apo grup makinerish).

Standardi EN 60034:2010 “Makinat elektrike rrotulluese - Pjesa 1: Vlerësimi dhe performance” është standard i harmonizuar nën Direktivën Evropiane 2004/08 për përputhshmërinë elektromagnetike, për zbatimin e të cilit janë të domosdoshme publikimi më i fundit i standardeve të mëposhtëme, e cila nuk është listë e mbyllur:

*IEC 60027-1: EN 60027-1: IEC 60027-4: EN 60027-4: TEC 60034-2: Seria e EN 60034-2: IEC 60034-3: EN 60034-3: IEC 60034-5: EN 60034-5: IEC 60034-8: EN 60034-8: IEC 60034-12: EN 60034-12: IEC 60034-15: EN 60034-15: IEC 60034-17: Seria e IEC 60034-18: Seria e EN 60034-18: IEC 60034-30: IEC 60038: IEC 60050-411: EN 60034-1:2010: IEC 60060-1: IEC 60072: IEC 60085: EN 60085: IEC 60204-1: IEC 60204-11: EN 60204-11 - IEC 60335-1: EN 60335-1 - IEC 60445: EN 60445 - TEC 60664-1: EN 60664-1 - IEC 609711): IEC 61293: EN 61293.*

**Standardi SSH EN ISO 14121** është i shfuqizuar dhe zëvendësuar me standardin **SSH EN ISO 12100** “Siguria e makinerive - Parimet e përgjithshme për projektim - Vlerësimi i rrezikut dhe reduktimi i tij”, sic jepet më lart.

**Standardi SSH EN ISO 3744** “Akustika - Përcaktimi i niveleve të fuqisë së zhurmës/zërit dhe nivelet e energjisë së zhurmësizërit të burimeve të zhurmës, duke përdorur presionin e zhurmësi zërit - Metodatat inxhinierike për një fushë në thelb të lirë mbi një rrafsh reflektues”. Edhe ky standard është standard i harmonizuar nën Direktivën Evropiane 2006/42 “Për Makineritë” **dhe specifikon metodat për përcaktimin e nivelit të fuqisë së zhurmës/zërit ose nivelit të energjisë së zhurmës/zërit të një burimi zhurme nga nivelet e presionit të zhurmës/zërit të matur në një sipërfaqe që mbështjell burimin e zhurmës (makineri ose pajisje) në një mjedis që për afrohet me një fushë të lirë akustike pranë një ose më shumë planeve reflektuese.”**

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

#### Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, vlen të theksojmë, se për sa i përket pretendimit të autoritetit kontraktor të paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik ku informon se: “[...]Po në datë 15.04.2024 në portalin E-Albania është depozituar ankesa e parë nga operatori ekonomik “SAHORA” shpk. Autoriteti Kontraktor me shkresat nr.800 prot date 18.04.2024 dhe 800/1 prot date 22.04.2024, ka njoftuar KPP-në mbi Vendimin e Komisionit të shqyrtimit të ankesës, i cili konkludoi në mospranimin e ankesës, për shkak se ankimuesit nuk i kishte lindur e drejta e ankesës sipas dispozitave ligjore. KPP me Vendimin nr. 383/2024 prot., datë 23.04.2024, vendosi të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “SAHORA” SHPK, pasi ankesa e dorëzuar nga OE ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranim. Gjithashtu, KPP ndër të tjera referon edhe pikën 7 të nenit 110 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku citohet: Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet



*ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

*Për sa më sipër, referuar nenit 110 pika 7 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Operatori Ekonomik “SAHORA” shpk, nuk mund ta ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë AK dhe KPP.*

*Në këto kushte, pretendimet dhe ankesa e operatorit ekonomik “SAHORA” SHPK, nuk merren në konsideratë.” [...]” sqarojmë, se operatori ekonomik “SAHORA” SHPK ka paraqitur ankim në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit, si pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike brenda afatit ligjor të parashikuar nga nenin 110, pika 2 e ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, pasi nga momenti i pulikimit të njoftimit të fituesit paraprak ai ka pasur 7 ditë në dispozicion për të paraqitur ankesë, veprim të cilin e ka kryer duke e paraqitur atë në sistem njëherazi në të dyja institucionet brenda afatit ligjor të përcaktuar më sipër. Sa më lart, operatori ekonomik ankimues “SAHORA” SHPK ka paraqitur ankim në rrugë elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, sipas të gjitha kushteve formale dhe afateve të parashikuara ligjore, në lidhje me procedurën objekt-shqyrtimi.*

III.2. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “SAHORA” SHPK, për skuafikimin e tij nga procedura e prokurimi me arsyen se: *“Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.1.1 të Kapacitetit profesional, pasi referuar ekstraktit të QKB, nuk ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.”* KPP vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, gërma “a” e dokumentave të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon:

*Ofertuesi deklaron se:*

*a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*[...]*

*Këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.*

III.2.2. Në shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, ndër të tjera, parashikohet se:

***Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit***

***A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT***

### ***Deklarata***

*Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

III.2.3. Nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik “SAHORA” SHPK rezulton, se është paraqitur:

*Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit*

#### ***DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT***

*Deklarata Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Vërtetuar nëpërmjet:*

*Dokumenti: [EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR].*

*Lëshuar nga: [Ministria e Financave dhe Ekonomise, Qendra Kombetare e Biznesit].*

*Adresa e Ueb-it: [Portali E-Albania].*

III.2.4. Neni 25 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes”, i VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se:

*“Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.*

*Këto kriteret synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.”*

III.2.5. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

*Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.2.6. Në nenin 92/3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se:

*“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.2.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për 14 përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit

publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.2.8. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “SAHORA” SHPK, për sa i përket objektit të veprimtarisë nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në fjalë, rezulton, se në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, gërma “A” “Deklarata për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit”, është deklaruar: “Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Vërtetuar nëpërmjet:*

Dokumenti: [EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR].

Lëshuar nga: [Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra Kombëtare e Biznesit].

Adresa e Ueb-it: [Portali E-Albania].” Gjithashtu, nga verifikimi i Ekstraktit historik të regjistrit për të dhënat e subjektit “SAHORA” SHPK, të publikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit rezulton, se objekti i aktivitetit është përcaktuar: “Importi, exporti, tregtimi me shumice, pakice dhe montimi i materialeve të ndryshme hidraulike, hidrosanitare, elektrike, pajisjeve dhe veglave të ndryshme të punës, automjeteve me goma dhe zinxhire të tipeve të ndryshme, makinerive, pajisjeve dhe impianteve të ndryshme të karakterit publik, industrial, bujqësor, tregtar, kulturor, sportiv, të sherbimeve, pjese kembimi, goma të ndryshme, bateri automjesh etj. Tregti me shumice dhe pakice të materialeve të pastrimit, dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim, kryerjen e të gjitha sherbimeve që lidhen me to. Sherbime në fushën e Informatikës dhe Teknologjisë, Konsulencë në Menaxhim Biznesi dhe promovim. Shoqëria mund të ushtroje gjithashtu edhe aktivitete të tjera ndihmëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi të konsideruara përfitim dhe të dobishme për arritjen e objektivave të saj kryesor.” Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “SAHORA” SHPK është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi nga ana e tij është plotësuar formulari i përgjithshëm i vetëdeklarimit, lidhur me objektin e veprimtarisë së tij, si dhe në objektin e veprimtarisë së shoqërisë “SAHORA” SHPK, sipas ekstraktit historik si më sipër cituar rezulton, se përfshihet objekti i prokurimit.

Sa më lart, pretendimi i i operatorit ekonomik “SAHORA” SHPK, qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “SAHORA” SHPK për skualifikimin e ofertës së tij me arsyet: “Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje

*të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.3.1. Në shtojcën 7, “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë:

*Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.*

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik në përmbushje të kriterit më sipër ka dorëzuar:

*-Dokumentet e ofertës së tij të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik.*

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.3.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe

*personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.3.5. Kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.3.6. Komisioni Prokurimit Publik referuar arsyes së skualifikimit të cituar në raport audit nga komisioni i vlerësimit të ofertave, si dhe pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimes “SAHORA” SHPK dhe skualifikimin e tij, nuk e ka bërë në përputhje me vetë kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, duke skualifikuar operatorin ekonomik ankimes “SAHORA” SHPK në mënyrë abuzive dhe të paargumentuar, pa përcaktuar se cili nga dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik

ankimues nuk është origjinal apo kopje e noterizuar. Gjykojmë, se ashtu sikurse është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, të vërtetohet se disponon kapacitetet tekniko-ligjore në lidhje me përmbushjen e kërkesave për kualifikim si dhe të specifikimeve teknike të kërkuara, edhe autoriteti kontraktor (komisioni vlerësimit të ofertave) ka barrën e provës të vërtetohet dhe argumentohet, se cili nga dokumentet e ngarkuara në sistem nuk është origjinal apo nuk është kopje e noterizuar me origjinalin duke mirëargumentuar edhe mosplotësimin e tyre. Bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, barra e provës në rastin konkret për vërtetueshmërinë e pretendimit (arsyes së skualifikimit), i takonte komisionit të vlerësimit të ofertave të identifikonte në mënyrë të saktë dhe të qartë, se cili nga dokumentet e ofertës nuk është origjinal apo kopje e njësuar me origjinalin duke dhënë argumentet mbi këtë fakt, i cili në rastin konkret ka dështuar t’i evidentojë dhe t’i argumentojë. Nuk mund të lejohet skualifikimi i një operatori ekonomik, në rast se autoriteti kontraktor nuk ka evidentuar në mënyrë të qartë se cili prej dokumenteve të ofertës të paraqitura në sistemin e prokurimit elektronik nuk është origjinal apo kopje e njësuar me origjinalin. Në këtë kuadër KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit, e pasqyruar në raport-audit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave se: “*Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.*” është e pabazuar dhe është detyrë e zyrtarëve përgjegjës, anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të pasqyrojnë në SPE vlerësimin e tyre, në mënyrë të qartë, konkrete dhe të kuptueshme. Referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtësisë, (shiko Çështjen C-27/15 Pippo Pizzo) ka konkluduar, se shkaqet e skualifikimit duhet të përcaktohen qartësisht dhe të publikohen paraprakisht në kohë të mjaftueshme, me qëllim që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të njihen me këto shkaqe. GJED në vendimin e mësipërm ka konfirmuar, se “përcaktim qartësisht” i shkaqeve të skualifikimit, do të thotë që të garantohet, se ofertuesit janë njohur me kërkesat specifike procedurale dhe që të njëjtat kërkesa, aplikohen njëjloj për të gjithë ofertuesit.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se shkeljet e mësipërme, cenojnë në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike. Në jurisprudencën e saj Inter Allia, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se “*Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin*”. Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret parimi i sigurisë



juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “SAHORA” SHPK qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “SAHORA” SHPK për skualifikim e operatorit ekonomik “VASAA” SHPK për shkak se nuk ka përmbushur kriterin “ **2.3.2** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e Cilësisë ISO 9906:2012 të klasës 3B; më të lartë ose (ekuivalente me të) mbi komformitetin e standardeve europiane të lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë si: SSH EN 809; SSH EN ISO 12100; SSH EN 60034, SSH EN ISO14121; SSH EN ISO 3744.*” KPP vëren se,

III.4.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përfundimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.4.2. Marrë shkas nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga verifikimi i kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi bazën e të cilit është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se ky kriter është hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, pasi në vetvete është një kriter konfuz dhe i paqartë dhe konkretisht KPP vëren se,

III.4.3. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik pika 2.3.2 autoriteti kontraktor ka kërkuar:

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e Cilësisë **ISO 9906:2012 të klasës 3B; më të lartë** ose (ekuivalente me të) mbi komformitetin e standardeve europiane të lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë si: **SSH EN 809; SSH EN ISO 12100; SSH EN 60034, SSH EN ISO14121; SSH EN ISO 3744.**

III.4.4. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.4.5. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet, se autoriteti kontraktor në kriterin më sipër ka kërkuar, që **“2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e Cilësisë ISO 9906:2012 të klasës 3B; më të lartë ose (ekuivalente me të) mbi komformitetin e standardeve europiane të lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë si: SSH EN 809; SSH EN ISO 12100; SSH EN 60034, SSH EN ISO14121; SSH EN ISO 3744.”** Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Referuar kriterit për kualifikim të sipërcituar, si dhe nga përgjigjia e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit me nr. 213/1 prot., datë 03.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1113/6 prot., datë 05.06.2024, e cila njofton se: *“Lidhur me sa kërkonti në shkresën Tuaj me nr.1113/44 prot, datë 28.05.2024, “Kërkesë për informacion”, ju informojmë se Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, bazuar në Ligjin nr.9870/2008 “Për Standardizimin”, të ndryshuar, nuk disponon informacion mbi ekzistencën e certifikatave të cilësisë që lëshohen nga organizma të certifikimit mbi shkallën e zbatimit të një standardi të caktuar, në rastin konkret të standardit ISO 9906:2012, klasa 3B.”* Komisioni gjykon, se kjo kërkesë është në kundërshtim me legjislacionin sekotrial në fuqi në fushën e standardizimit, pasi vetë organi kompetent Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit sqaron, se nuk disponon informacion mbi ekzistencën e certifikatave të cilësisë që lëshohen nga organizma të certifikimit mbi shkallën e zbatimit të një standardi të caktuar, në rastin konkret të standardit ISO 9906:2012, klasa 3B. Akoma më tej, ky institucion në kthim - përgjigje mbi kërkesën më sipër të KPP ndër të tjera ka sqaruar dhe se: **“Standardi SSH EN ISO 14121 është i shfuqizuar dhe zëvendësuar me standardin SSH EN ISO 12100** *“Siguria e makinerive - Parimet e përgjithshme për projektim - Vlerësimi i rrezikut dhe reduktimi i tij”, sic jepet më lart.”* Referuar këtij sqarimi KPP gjykon, se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.2 në kriteret e veçanta të kualifikimit përveçse është në kundërshtim me legjislacionin sektorial në fuqi për arsyen e shpjeguar më sipër, ai është dhe një kriter konfuz dhe i paqartë, sepse sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, Standardi SSH EN ISO 14121 është i shfuqizuar dhe zëvendësuar me standardin SSH EN ISO 12100, ndërkohë që në kriterin më sipër, autoriteti kontraktor ka përcatuar si kusht për kualifikim të dyja standardet, si standardin SSH EN ISO 12100 në fuqi, ashtu edhe Standardin SSH EN ISO

14121 të shfuqizuar, duke krijuar kontradiktë dhe konfuzion, si tek operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave të tyre ashtu edhe tek Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në momentin e vlerësimit të procedurës së prokurimit.

KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe Gjykata Europiane e Drejtësisë (GJED) ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar një kriter në kundërshtim me legjislacionin sektorial në fuqi në fushën e standardizimit, si dhe kontradiktor e të paqartë, i cili shkakton konfuzion në përgatitjen e ofertave dhe në mënyrën e vlerësimit të tyre, duke rënë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik. Kështu që, në lidhje me pretendimin e mësipërm të ankimuesit, nuk mund të garantohet një mjet ankimi efektiv, pasi KPP nuk mund të shprehet mbi themelin e kërkesave, duke qenë se kriteri i hartuar nga autoriteti kontraktor **“2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e Cilësisë ISO 9906:2012 të klasës 3B; më të lartë ose (ekuivalente me të) mbi komformitetin e standardeve europiane të lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë si: SSH EN 809; SSH EN ISO 12100; SSH EN 60034, SSH EN ISO14121; SSH EN ISO 3744.”** është në kundërshtim me legjislacionin sektorial në fuqi dhe me legjislacionin për prokurimin publik, pasi është një kriter i paqartë dhe kontradiktor, i cili shkakton konfuzion në përgatitjen e ofertave si dhe në vlerësimin e tyre. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e kualifikimit si dhe specifikimet teknike duhet të përcaktohen të qarta dhe të sakta nga autoriteti kontraktor si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, si atë sektorial dhe për prokurimin publik, volumin dhe objektin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

III.4.6. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, sipas të cilit: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit, në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

[...] ”Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor është në kundërshtim me legjislacionin sektorial në fuqi dhe me legjislacionin për prokurimin publik, pasi është një kriter i paqartë dhe kontradiktor i cili shkakton konfuzion në përgatitjen e ofertave si dhe në vlerësimin e tyre, kjo përbën shkak për anulimin e procedurës. Në kushtet kur autoriteti kontraktor ka vlerësuar mbi kritere jo në përputhje me legjislacionin sektorial dhe atë për prokurimin publik, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

III.5. Lidhur me pretendimin tjetër të paraqitur nga ankimuesi për mospërmbushjen nga operatorin ekonomik “VASAA” SHPK të kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.4 të kriterëve ë veçanta për kualifikim për ekonomi në procesin e shqyrtimit administrativ, nuk do të merret në shqyrtim, pasi referuar arsytimit më sipër të KPP-së, procedura e prokurimit do të anulohet dhe ankimuesi nuk ka më interes të ligjshëm mbi pretendimet e tjera.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “SAHORA” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-97126-03-04-2024, me objekt: “Blerje elektropompa zhytëse e panele”, me fond limit 18,000,000 (tetëmbëdhjetë milion) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.A.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera dhe duke dërguar dokumentet e reja të procedurës së prokurimit të modifikuara sipas konstatimeve të mësipërme.

4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “SAHORA” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Fiovent Zguro</b>	<b>Kreshnik Ternova</b>	<b>Anila Malaj</b>	<b>Gjergj Mersini</b>

**Kryetar**

**Jonaid Myzyri**

